REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 8731 Prot.

Lushnje,më 14/09/2026

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK
MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2026 NGA TË ARDHURAT E TRASHËGUARA DHE TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR.
(Miratuar me VKB nr.122 datë 23.12.2025)

Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltar!

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në veçanti nenin 60/1, "Përdorim i fondeve të trashëguara nga viti i kaluar", Ligjin nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026", si dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit", shkresës nr.11241/3prot, datë 06.07.2026, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 6769 prot , datë 09.07.2026,

Si dhe në mbështetje të kërkesës së Klubit të Futbollit SHA Lushnjë, dhe pas rakordimit të të ardhurave të trashëguara nga viti 2025 për vitin 2026, ku rezulton se Bashkia Lushnjë disponon të ardhura të trashëguara të pashpërndara. Për sa më sipër, propozohet përdorimi i këtyre të ardhurave, si më poshtë:

1. Për financimin e Klubit të Futbollit SHA Lushnjë.

Për sa më sipër, propozojmë përdorimin e një pjese të të ardhurave të trashëguara të pashpërndara, në shumën **20,000,000 (njëzetmilionë) lekë**, për financimin e Klubit të Futbollit SHA Lushnjë, duke marrë në konsideratë nevojën për mbështetjen financiare të klubit dhe pamjaftueshmërinë e fondeve të miratuara për përballimin e nevojave dhe detyrimeve të tij.

Analiza e fondeve të miratuara dhe të përdorura deri në këtë periudhë paraqitet në tabelat bashkëlidhur, së bashku me kërkesën e Klubit të Futbollit "Lushnjë 1930" SHA.

2. Për financimin e objektit "Prishja dhe ndërtimi i shkollës së re 9 –vjecare 'Liri Kazazi',
Bashkia Lushnjë""

Referuar relacionit të Drejtorisë së Urbanistikës, nëpërmjet të cilit miratohet objekti me emërtimin **"Prishja dhe ndërtimi i shkollës së re 9-vjeçare 'Liri Kazazi"**, dhe nevojën e evidentuar nga komuniteti gjatë dëgjesave publike për hartimin e Buxhetit të Vitit 2026, të zhvilluara në fund të vitit 2025, për përmirësimin e infrastrukturës arsimore, propozohet shtimi i buxhetit të vitit 2026 në shumën

totale 17,211,241 (**shtatëmbëdhjetë milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzetë e një**) **lekë**, me burime financimi si më poshtë:

Burimi i financimit	**Shuma (lekë)**
Të ardhura të trashëguara nga viti 2025	15,000,000
Transfertë e përgjithshme e pakushtëzuar	2,211,241
Totali për vitin 2026	**17,211,241**

*Shuma prej **2,211,241 lekësh**, nga granti i pakushtëzuar, është alokuar nga Ministria nëpërmjet shkresës nr. **11241/3, datë 06.07.2026**, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. **6769 prot, datë 09.07.2026**, pa destinacion të përcaktuar.

*Ndërsa shuma prej **15,000,000 lekësh** do të përballohet nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2025, të disponueshme dhe të pashpërndara në buxhetin e vitit 2026

Vlera totale e objektit **"Prishja dhe Ndërtimi i Shkollës së Re 9 –Vjecare 'Liri Kazazi"** është **85,527,048.22 lekë**. Për vitin 2026, në buxhetin e Bashkisë Lushnjë propozohet të përfshihet shuma prej **17,211,241 lekë**, e cila përfaqëson financimin e parashikuar për këtë vit.

Pjesa e mbetur e vlerës së objektit, do të planifikohet dhe financohet në vitet buxhetore në vijim.(pakesim brenda programit).Pra :

Vlera totale e investimit është 85,527,048.22 lekë, e shtrirë në tre vite buxhetore, përkatësisht: për vitin 2026 në shumën 17,211,241.00 lekë, për vitin 2027 në shumën 34,157,903.61 lekë dhe për vitin 2028 në shumën 34,157,903.61 lekë.

Për sa më sipër, propozohet shtimi i buxhetit të vitit 2026 në shumën **17,211,241 lekë**, për financimin e objektit **"Prishja dhe ndërtimi i shkollës së re 9 –vjecare 'Liri Kazazi"**

Theksojmë se Bashkia Lushnje dhe Ndërmarrjet Vartëse nuk kanë detyrime të prapambetura të krijuara së fundmi. Detyrimet e prapambetura që rezultojnë të pa likujduara vijnë si rezultat i mungesës së dokumentacionit për likujdim.

Ju propozojmë miratimin e shtesës në Buxhetin e vitit 2026 dhe rishikimin PBA 2027-2029 .

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Drejtoria Fianacë - Buxhetit
Ervisa Çuko

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave
Juljana Hasalla

Drejtues Programi AA129

Maldrita Bardho

Adresa: Lagja Kongresi i Lushnjes Tel: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

Drejtora e Përgj i Zhvill Urban dhe Rural
Ariola Beqo

Qendra e Arsimit
Muarrem Sharka

Qendra Kulturore&Klub Sportit.
Brizida Dervishi

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 8731/1 Prot.

Lushnje, më 14/09/2026

PROJEKT-VENDIM
NR 82 DATË 14.09.2026
KËSHILLIT BASHKIAK
MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2026 NGA TË ARDHURAT E TRASHËGUARA DHE TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR.
(Miratuar me VKB nr.122 datë 23.12.2025)

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës _____ 2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, **"Mbi një shtesë në Buxhetin e Vitit 2026 nga të ardhurat e trashëguara dhe transferta e pakushtëzuar"**, mbështetur në Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjin nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026"; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në veçanti nenin 60/1, "Përdorimi i fondeve të trashëguara nga viti i kaluar"; Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, të Ministrisë së Financave, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar; Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026"; si dhe shkresës nr. 11241/3 prot, datë 06.07.2026, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 6769, datë 09.07.2026,

PROPOZOJMË:

1. Të rriten të ardhurat e trashëguara të Buxhetit për vitin 2026 në shumën **35,000,000 (tridhjetë e pesë milionë) lekë**, nga të cilat:

- **20,000,000 lekë** për financimin e Klubit të Futbollit SHA Lushnjë;
- **15,000,000 lekë** për financimin e objektit **"Prishja dhe Ndërtimi i Shkollës së Re 9 –Vjecare 'Liri Kazazi".**

2. Të rriten të ardhurat nga **granti i pakushtëzuar** për vitin 2026 në shumën **2,211,241 (dy milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e një) lekë**, të akorduara nëpërmjet shkresës nr. 11241/3, datë 06.07.2026, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 6769, datë 09.07.2026, pa destinacion të përcaktuar.

3. Të rriten shpenzimet e Buxhetit të Bashkisë Lushnjë për vitin 2026 në shumën totale **37,211,241 lekë**, si më poshtë:

- në programin përkatës për financimin e **Klubit të Futbollit SHA Lushnjë**, në shumën **20,000,000 lekë**;(AE129, Art, Kulturë, Sport & Turizëm pranë"Qendra Kulturore & Klub Shumë Sport.")
- në programin përkatës të investimeve, në artikullin **231**, për financimin e objektit **"Prishja dhe ndërtimi i shkollës së re 9 –vjecare 'Liri Kazazi"**, në shumën **17,211,241 lekë**.
- Vlera totale e investimit është 85,527,048.22 lekë, e shtrirë në tre vite buxhetore, përkatësisht: për vitin 2026 në shumën 17,211,241.00 lekë, për vitin 2027 në shumën 34,157,903.61 lekë dhe për vitin 2028 në shumën 34,157,903.61 lekë.
  (Rishikimi i PBA-së brenda programit.)(AC129,Kodi do celet pas miratimit)

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen **Drejtoria e Financë-Buxhetit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Publike e Zhvillimit Urban dhe Rural, Drejtoria Juridike ,Zyra e Prokurimeve,Qendra Kulturore dhe Klubi i Sportit.**

5. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria Fianacë - Buxhetit
Ervisa Çuko

Për Drejt e Përgj të Menaxh Financ dhe të Ardh.
Juljana Hasalla

Drejtues Programi AA129
Maldrita Bardho

Drejt. e Përgj i Zhvill Urban dhe Rural
Ariola Beqo

Drejtoria Juridike
Bedri Hida
P. Enejd Dhamo

Qendra e Arsimit
Muarrem Sharka

Qendra Kulturore&Klub Sport.
Brizida Dervishi

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE